



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:063981
Datë: 21.12.2023
Numri i dokumentit: 05104839

PPP.nr.231/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florian Krasniqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K., sh.a. me seli në Prishtinë, rruga “.....” nr., kundër debitorit I.R, nga Prishtina, rruga “.....”, numër ..., Prishtinë, në çështjen juridike përmbarimore për pagimin e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.2631/2018, të datës 19.12.2018, të lejuar nga përmbaruesi privat Rezarta Metaj, në Prishtinë, jashtë seance, me datë 21.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit I.R, SHFUQIZOHET urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.2631/2018, i datës 19.12.2018, i lejuar nga përmbaruesi privat Rezarta Metaj në Prishtinë, dhe përfundohet procedura e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Zyra Përmbarimore e përmbaruesit privat Rezarta Metaj në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhër në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstrakti nga librat afarist, për borxhin në vlerë prej 822.34 €, për periudhën nga data 12.06.2008 deri me datë 20.03.2013, ashtu që është detyruar debitori që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 822.34 €, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbarimit deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Në të kundërtën përmbaruesi do të realizohet me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogarinë bankare dhe do të bëhet bartja e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, ose do të bëhet ndalimi i mjeteve në të ardhura personale ose përmbarimi do të

realizohet përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbarimit debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim. Në prapësim ka theksuar se borxhi është parashkruar tërësisht sipas nenit 378 par 1 apo 372, të LMD-së së vjetër, si dhe 360 të LMD-së, tutje ka theksuar se, debitori e ka përmbaruar në tërësi borxhin e tij ndaj kreditorit, sipas marrëveshjes për pranimin e borxhit, dhe se borxhi i vetëm është borxhi prej 63,66 euro. Po ashtu ka theksuar se mohon borxhin e tij ndaj kreditorit, kjo për faktin se, faturimi është bërë në mënyrë paushalle, dhe se borxhi ja rëndon gjendjen ekonomike – sociale. Andaj në këtë kuptim gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Kreditori brenda afatit të caktuar ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se prapësimi i debitorit dhe pretendimet e paraqitura përmes tij janë të pa bazuara dhe ka propozuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi. Ka theksuar se dokumenti përmbarimor – ekstrakti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore i plotëson të gjitha kushtet për të qenë dokument i përmbarueshëm. Tutje ka theksuar se borxhi i cili kërkohet të përmbarohet nuk është i parashkruar për shkak se debitori ka nënshkruar marrëveshje për pranimin e borxhit me kreditorin, dhe kjo marrëveshja e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit të debitorit, ngase debitori ka bërë tre pagesa të kësteve sipas kësaj marrëveshje.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm – ekstraktin nga librat afariste DPR-115315, të datës 18.12.2018, në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se i njëjti paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave shihet se, kërkesat për furnizim me energji elektrike parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të tërësishëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së. Kreditori ka kërkuar përmbarimin e borxhit për periudhën nga data 12.06.2008 deri me datë 20.03.2013. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i kreditorit është parashkruar, ngase nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi për përmbarim datë 19.12.2019, kanë kaluar më shumë se një vit, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret lidhur me periudhën kohore të cekur si më lartë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo për faktin se ka kaluar koha e paraparë me ligj brenda të cilit kreditori mund të kërkojë përmbarimin e detyrueshëm të kërkesës së tij karshi debitorit.

Sa i përket pretendimeve të kreditorit për ndërprerje të parashkrimit, për shkak se debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme të kësteve të borxhit, gjykata sjell në vëmendje se kërkesat periodike janë kërkesa të veçanta nga njëra tjetra dhe afatet e parashkrimit rrjedhin për secilën kërkesë veç e veç, nga momenti i arritjes për pagesë e tutje. Duke qenë kërkesa të veçanta, gjykata po ashtu sjell në vëmendje dispozitën e nenit 293 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) e cila përcakton: *1. Kur midis personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëjlojta, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t'i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes. 2. Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje. Sipas kësaj dispozite, kur në mes të kreditorit dhe debitorit ekzistojnë detyrime të njëjlojta, palët me marrëveshje mund të caktojnë radhën e përmbushjes së detyrimeve në mes tyre, ndërsa nëse nuk është caktuar me marrëveshje radha e detyrimeve që do të përmbushen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë, siç kanë arritur për pagesë, pra janë maturuar për përmbushje. Në këtë kuptim, referuar situatës konkrete në këtë çështje përmbarimore, gjykata vlerëson se, tek detyrimet e debitorit ndaj kreditorit, në rast se debitori kryen pagesa dhe në pagesë e thekson saktë numrin e faturës të cilën e ka paguar, atëherë parashkrimi ndërpritet vetëm për atë faturë për të cilën është kryer pagesa, ndërsa në rastet kur kryhen pagesa, por pa e përcaktuar decidivisht numrin e faturës e cila paguhet, atëherë shuma e paguar e borxhit llogaritet si përmbushje e detyrimit më të vjetër të arritur për pagesë, dhe një pagesë e tillë nuk ka për konsekuencë edhe ndërprerjen e parashkrimit për të gjitha faturat, për shkak se siç u lartë theksua kërkesat periodike janë kërkesa të veçanta nga njëra tjetra. Për më tepër edhe sipas interpretimeve*

dhe konstatimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të dhëna në aktgjykimin e saj Rev.nr.148/2012, dt.09.09.2013, në një rast tjetër gjyqësor, me rastin e sqarimit të çështjes së ndërprerjes së parashkrimit me pagimin e borxhit, e njëjta gjykatë sqaron dhe konstaton se edhe pagesat e bëra të kohë pas kohe lidhur me borxhin periodik, nuk e bënë ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ngase në rastin konkret borxhi për shpenzimet e energjisë elektrike është borxh periodik i cili arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe afati i paraparë në nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, për parashkrim rrjedh për secilin muaj nga momenti i përfundimit të atij muaji, që do të thotë parashkrimi tek borxhi periodik që ka të bëjë me shpenzimin e energjisë elektrike, llogaritet në secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Sa i përket pretendimit të kreditorit se debitori ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaratën mbi dakordimin e borxhit, dhe ka paguar këstet e borxhit, andaj rrjedhimisht edhe është ndërprerë parashkrimi, Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla të kreditorit janë të pabazuara. Kjo për faktin se në shkresat e lëndës nuk kemi asnjë marrëveshje – kontratë për pagesën e borxhit, si dhe deklaratës mbi dakordimin e borxhit të nënshkruara në mes kreditorit dhe debitorit I.R. Kontrata për pagesën e borxhit nr.56017, e dt.24.07.2017, deklarata mbi dakordimin e borxhit nr.56017, e dt.24.07.2017, si dhe deklarata mbi poseduesin faktik me shifrën e konsumatorit 115315, të cilave dokumente ju referohet kreditori, janë dokumente që janë nënshkruar në mes kreditorit dhe Rr.R. Në asnjë nga provat të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, nuk kemi autorizim sipas së cilës vërtetohet se debitori I.R, e ka autorizuar Rr.R, që të nënshkruaj dokumentet në fjalë. Gjykata po ashtu sjell në vëmendje Udhëzimin Administrativ (qrk) - nr. 04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike, gjegjësisht neni 7 i këtij udhëzimi administrativ, paragrafi 1 i të njëjtit i cili përcakton si në vijim: *1. Personat, të cilët kanë borxhe para dhe pas 31 dhjetor 2008 dhe personat që kanë borxhe vetëm pas datës 31 dhjetor 2008, nëse janë pajtuar me shumën e borxhit, nuk kanë ushtruar ankesë apo Komisioni i Ankesave ka vendosur për ankesën e tyre, nënshkruajnë me Institucionet apo Ndërmarrjet Publike “ deklaratën mbi dakordimin e Borxhit” (e bashkëngjitur në Shtojcën Nr. 1), në të cilën janë të pasqyruara shuma e kryegjësë, ndëshkimet, gjobat, interesi si dhe obligimet tjera që rrjedh nga mospagesa e kryegjësë së borxhit sipas viteve, deri më 31 dhjetor 2014, dhe paragrafi 2 i këtij udhëzimi administrativ i cili përcakton: Për kategoritë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në rastet kur pronari faktik i objektit apo subjektit nga i cili buron borxhi publik nuk është edhe pronar juridik, Institucionet dhe Ndërmarrjet Publike nënshkruajnë me personat përfitues “deklaratën e Poseduesit Faktik” (e bashkëngjitur në Shtojcën Nr. 2), në të cilën personi, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve, pranon posedimin faktik të objektit apo subjektit nga i cili buron borxhi publik. Sipas kësaj dispozite të udhëzimit administrativ në fjalë, përcaktohet se kreditori nënshkruan marrëveshje me poseduesin faktik, kur përfituesi i faljes së borxhit publik nuk është edhe pronar juridik i objektit nga ka rrjedhur borxhi. Mirëpo në këto raste, sipas paragrafit 2 të nenit 7 të udhëzimit administrativ të lartë cituar, përfituesi i faljes së borxhit është vet poseduesi faktik. Në rastin konkret, deklarata për posedues faktik është nënshkruar me personin Rr.R, që nënkupton se Rr.R si nënshkruer i deklaratës për posedim faktik dhe marrëveshjes – kontratës për pagesën e borxhit është përfitues i faljes së borxhit.*

Andaj, në prani të këtyre rrethanave gjykata arrin në përfundim se debitori asnjëherë në asnjë rrethanë, me asnjë provë shkresore, nuk ka asnjë marrëveshje me kreditorin, me anë të së cilave

ka bërë pranimin e borxhit i cili tani është objekt i përmbartimit, dhe se i njëjti nuk ka përfituar nga falja e borxheve, dhe si rezultat i kësaj, gjykatës pretendimet e paraqitura nga debitori në prapësim i kanë rezultuar si të bazuara.

Gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: . ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi”*, e që në rastin konkret të çështjes juridike në fjalë është vërtetuar se kemi të bëjmë me parashkrim të tërësishëm të kërkesës së kreditores.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj në tërësi në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbartimore si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mbështet në nenin 73 paragrafi 4 sipas Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.231/2019, dt.21.12.2023

KËSHILLA JURIDIKE

Gj y q t a r i
Florian Krasniqi

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.